



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:127763

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05752933

C.nr.3870/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.M. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me autorizim avokate R.H. nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Obiliqit, të cilën e përfaqëson av. G.H. , nga Prishtina, me autorizim të bartur nga av. Nazim Mehmeti nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i ushqimit në punë, kualifikimit dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 5,593.76 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, në të cilën të pranishëm ishin përfaqësuesit e palëve, me datë 29.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.M. nga Prishtina dhe DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit në punë për 596 ditë pune nga data 12.03.2020 - 21.11.2022 t'ia paguajë shumën prej 1,192.00 euro, në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit – master për periudhën kohore 21.06.2018 - 06.02.2023, përkatësisht për 56 muaj, nga 78 euro për secilin muaj t'ia paguajë shumën prej 4,368.00 euro, si dhe në emër të kompensimit për shpenzime të udhëtimit nga data 12.03.2020 - 21.11.2022 t'ia paguajë shumën prej 333.76 euro, e gjithsej shumën prej 5,593.76 euro me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 21.06.2021 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjyqimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 259.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m i**

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me datë 21.06.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi ushqimit në punë, kualifikimit dhe shpenzimeve të udhëtimit.

Paditësi, në padi, si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se paditësi është i punësuar në SHMLP “/” në Obiliq ku i ka mbi 8 vjet përvojë pune, ndërsa për periudhën kohore 12.03.2020 - 21.11.2022 ka qenë i pranishëm në punë 596 ditë pune. Tutje ka theksuar se paditësi është me

kualifikim - master, ndërsa paga bazë e tij për këtë periudhë ka qenë 459 euro në muaj, ndërsa i njëjti në emër të kualifikimit ka pranuar shumën mujore prej 82.55 euro, kurse i kanë takuar 160.65 euro. Padiësi ka banuar në Prishtinë dhe ka udhëtuar për në vendin e punës në Obiliq ku çmimi i biletës vajtje – ardhje është 0.80 euro. Kështu ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e padiësit M.M. nga Prishtina dhe të detyrohet e paditura Komuna e Obiliqit që padiësit në emër të kompensimit të ushqimit në punë për 596 ditë pune nga data 12.03.2020 - 21.11.2022 t'ia paguajë shumën prej 1,192.00 euro, në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit – master për periudhën kohore 21.06.2018 - 06.02.2023, përkatësisht për 56 muaj, nga 78 euro për secilin muaj t'ia paguajë shumën prej 4,368.00 euro, si dhe në emër të kompensimit për shpenzime të udhëtimit nga data 12.03.2020 - 21.11.2022 t'ia paguajë shumën prej 333.76 euro, e gjithsej shumën prej 5,593.76 euro me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 21.06.2021 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm..

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 259 euro.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigje në padi dhe në seancë gjyqësore e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e padiësit si të pabazuar, për arsye se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive të datës 18.04.2017, në të cilën e bazon kërkesëpadinë padiësi, e rrjedhimisht kjo kontratë nuk mund të ketë implikime financiare për të paditurën, por vetëm për palët nënshkruese, ndërsa sa i përket gjendjes faktike ka deklaruar se për ta nuk është kontestuese gjendja faktike, por vetëm baza ligjore.

Gjykata për ta vërtetuar sa më saktë dhe drejtë gjendjen faktike, administroi provat materiale si: Kontrata e punës e datës 01.09.2020; Diplomë lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e datës 17.12.2023; Lista e pagave të muajit prill 2021; Lista e pagave të muajit nëntor 2018; Licenca e punës e datës 29.12.2016; Vërtetim nga Kastrioti Sh.P.K i datës 23.02.2023 dhe Vërtetim nga SHMLP “/” në Obiliq, i datës 24.10.2023.

Pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, përkatësisht përfaqësuesve të tyre gjykata erdhi në përfundim se nuk ishte kontestuese gjendja faktike se padiësi është i punësuar në SHMLP “/” në Obiliq, ndërsa për periudhën kohore 12.03.2020 - 21.11.2022 ka qenë i pranishëm në punë 596 ditë pune. Nuk ishte kontestuese as fakti se padiësi është me kualifikim - master, ndërsa paga bazë e tij për këtë periudhë ka qenë 459 euro në muaj, ndërsa i njëjti në emër të kualifikimit ka pranuar shumën mujore prej 82.55 euro. I njëjti ka banuar në Prishtinë dhe ka punuar në Obiliq dhe çmimi i biletës vajtje - ardhje ka qenë 0.80 euro.

Kjo gjendje faktike edhe pse jokontestuese, ishte në përputhje të plotë me provat e administruara më sipër.

Gjykata konstaton se në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese është vetëm baza ligjore lidhur me kërkesën e padiësit.

Sa i përket bazës ligjore, gjykata vendimin lidhur me kërkesën për kompensim në bazë të kualifikimit e ka bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik,

Nr.08/L-196), në të cilin është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësit, drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10% të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me një ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, në këtë rast, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023, të datës 05.10.2023.

Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes në përputhje me kualifikim - master, për periudhën 21.06.2018 - 06.02.2023, pasi siç u konstatua më sipër paditësit i është paguar vetëm shuma prej 82.55 euro për kualifikim, ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, paditësi është dashur të paguhet në shumën prej 160.55 euro, por se i njëjti nuk është paguar nga e paditura në shumë prej 78 euro në muaj, e që kjo shumë për 56 muaj është e barabartë me shumën prej 4,368.00 euro, dhe kështu gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t'ia paguajë këtë shumë për kërkesën për kompensim mbi bazën e kualifikimit.

Vendimin për shpenzime të ushqimit dhe udhëtimit gjykata e ka bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me datën 18.04.2017, e cila ka qenë e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj, e deri me datë 21.01.2021, si dhe në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021, e cila ka qenë në fuqi deri më 21.11.2022, në vazhdim KKAK-të.

Neni 2, paragrafi 1 i KKAK-ve përcakton se *“Dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit para universitare (parashkollor, filllore, të mesme të ultë, të mesme të lartë, shkolla speciale dhe qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, [...]”*. Ndërsa, paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in, etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.*

Po ashtu, me nenin 35, paragrafi 7 të KKAK-ve, parashihet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditës e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. [...]”*, ndërsa me nenin 35, parag. 5 të KKAK-ve, parashihet se *“Punonjësve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*.

Në rastin në fjalë gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim t'ia paguajë paditësit kompensimin për ushqimin gjatë punës dhe shpenzime të udhëtimit. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 35, paragrafi 7 dhe 5 të KKAK-ve.

Gjykata e detyroi të paditurën që paditësit t'ia paguajë shumën prej 1,192.00euro në emër të shujtave ditore, pasi që nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë në punë 596 ditë, ndërsa dispozita e lartcekur e obligon të paditurën që për çdo ditë të pranisë në punë të paditësit t'ia paguajë nga dy euro në ditë, e që për 596 ditë nga 2 euro është e barabartë me shumën prej 1,192.00 euro të aprovuar nga gjykata.

Gjykata, po ashtu, e detyroi të paditurën, që paditësit t'ia paguajë shumën prej 333.76euro në emër të shpenzimeve të udhëtimit, pasi që nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë në punë, dhe rrjedhimisht ka udhëtuar 596 ditë, në relacionin Prishtinë - Obiliq, dhe se bileta dy drejtimshe për këtë relacion ka qenë 0.80 euro, ndërsa sipas dispozitës së lartcekur, paditësit i takon vlera prej 70% e çmimit të biletës së trafikut, e që për 596 ditë nga 70% e çmimit të biletës së trafikut është e barabartë me shumën prej 333.76 euro të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës të parashtruara në seancë, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla nuk paraqesin bazë për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, për shkak se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratave Kolektive të Arsimit, të vitit 2017 dhe 2021, pasi që në nenin 2 të Kontratave është përcaktuar se “*kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të*”, ndërsa lidhur me kërkesën për kualifikim baza ligjore qëndron në vendimin e lartcekur të Qeverisë së Kosovës, i cili është i detyrueshëm për të paditurën.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës gjykata u bazua në Rregulloren për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, dhe Udhëzimin Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore. Shuma prej 259 euro konsiston në shpërblimin për përpilimin e padisë në shumë prej 104 euro, një seancë gjyqësore prej 135 euro dhe 20 euro në emër të taksës gjyqësore.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË**

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.3870/21, datë 29.05.2024

Gjyqtari,  
Freskim Musliu

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.